

Isra dhe Miraxh

“Pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Vet e kaloi në një pjesë të natës prej Mesxhidi Haramit (Qabes) deri në Mesxhidi Aksa (Kuds) rrethinën e të cilës Ne e kemi bekuar, (ia bëmë këtë udhëtim) për t’ia treguar nga argumentet Tona. Vërtet, Ai është dëgjuesi, pamësi.”¹

Fjala ISRA rrjedh nga gjuha Arabe dhe do të thotë “udhëtim natën”, dhe ka për qëllim udhëtimi i Muhamedit a.s. prej Mesxhidil Haram (Qabe) deri në Mesxhidil Aksa Xhamia në Jerusalemin e sodit, kurse MIRAXH do të thotë ngjytje në qiellrat e larta, dhe ka për qëllim udhëtimi i Muhamedit a.s. prej Mesxhidi Aksa deri në Sidretul Munteha (mbi qiellrat e larta)

Transmeton ibni Is’haku të cilin hadith e transmetojnë edhe: Abdullah ibn Mesudi, Ebu Seid el Huderij, Aishja, Muaviu, ibn shihabi, Katade dhe shumë dijetarë tjerë.

Thot Muhamedi a.s. më erdhi Xhibrili te shtrati dhe më lëkund, u zgjova nuk pashë kënd, rash sërish. Erdhi së dyti, më lëkund, u zgjova nuk pashë kënd rashë, erdhi së treti dhe më kapi për dore dhe më zgjoi, më çoi deri te Qabja dhe aty më priste Buraku.²

Ma vëndoi xhibrili a.s. Taxhin³ në krye dhe ma lau zemrën time me uj të Zemzemit⁴, dhe u drejtuam kah Buraku.

Kur desha të hyp në Burak, ai lëvizte dhe nuk mundesha. Xhibrili a.s. i tha: O Burak a stë vjen turp. Pasha Allahun, nuk të ka hyp më parë ndonjë njeri më i dashur te allahu se Muhamedi. Ai u turpërua dhe u ul që të ia lehtësojë hypjen Muhamedit a.s.

Për një çast aritëm në Mesxhidul Kuds (Jerusalem). Aty mu dhanë tri enë, njëra me uj, njëra me alkohol dhe njëra

¹ (El Isra 1)

² një kafshë më e vogël se Mushka dhe më e madhe se Gomari, kafshë e cila kishte mbajtur edhe Pejgamberët tjerë.

³ Taxh është një lloj kurrora për në krye që u vëndohet pejgamberëve, një gur i çmuar i saj është sa krejt bota dhe çka në të (sipas hadithit të Muhamedit a.s.) Në këtë botë kemi i vëndojnë Mbretërit.

⁴ Uji i Zemzemit është burim që gjendet në Mekke

Israja dhe miraxhi.doc-Bekim Alimi

me qumësht. (Në disa transmetime dy enë. Me qumësht dhe me alkohol).

E zgjodha enën me qumësht. Më tha Xhibrili e zgjodhe udhëzimin e Allahut për ty dhe ummetin⁵ tënd. Të kishe zgjedhur ujin do të u fundoseshte e tërë njerzia, të e kishe alkoholin do humbeshte njerëzia (dalalet).

Aty i pashë disa pejgamber. I pari ishte Ibrahim el Halili⁶. Nuk kam parë njeri më tepër që i përngjante këtij shokut tuaj se ai, iu tha Muhamedi a.s. shokëve të tij.

Aty ishte edhe Musa a.s. i cili ishte një njeri i gjatë dhe i hollë i cili iu përngjante Shen`udëve⁷. Pastaj aty qëndronte edhe Isau i biri i Merjemes. Ky ishte një njeri i kuq, jo shumë i gjatë e as i shkurtë, me flokë të zeza si të lagura. Më së shumti i ngjante Urvete ibn Mes`udit. I falëm dy rekate namaz me pejgamberët të cilëve kisha nderë t’iu bëhem Imam, e më pas me Xhibrilin dhe Burakun u nisëm për në Miraxh.

Kur arritëm te qielli i parë e që quheshte SEMAUD DUNJA (qielli i dunjasë) gjë më të bukur nuk kam parë në jetë, trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë. Rroja e kësaj dere ishte një Melaiqe⁸ me emrin Ismail, në udhëheqsinë e të cilit ishin 12.000 Melaiqe tjera nën secilë prej tyre edhe nga një Melaiqe. Pejgamberi a.s. tha : Mu kujtua ajeti i Kur`anit:

”Askush nukie din ushtarët e Allahut pos Tij”⁹

Ky Ismaili pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët.

Ai na priti me buzëqeshje dhe lutje Zotit për ne, dhe të gjithë Melaiket tjera ashtu, derisa e takuam një Melaiqe e cila na tha sikur tjerët por nuk qeshte.

I thash o Xhibril, pse nuk qesh edhe kjo si të tjerët. Xhibrili a.s. mu përgjegj: Askuj më parë nuk i ka qesh kjo melaiqe, e as më mbrapa nuk do ti qesh. Sikur ti kishte qeshur dikuj në botë do të qeshte ty o Muhamed. Kjo është Melaikeja e zjarrit (Xhehenemit). I thash a është kjo për të cilën thot Allahu në Kur`an: **“Që është i respektuar në mesin e engjujve dhe besnik”¹⁰** Ai mu përgjigj po. I thash xhibrilin a.s. ti thotë të ma e tregon Xhehenemin. Kur e

⁵ popullin

⁶ El Halil- Llagapi i Ibrahimit a.s. nga Allahu xh.sh. e që do të thot Shok i dashur i Tij.

⁷ Një fis Arab

⁸ Engjëll

⁹ El Mudeththir 31

¹⁰ Etekwir 21

zbuloi mbulesën e xhehenemit mendova se na gëlltiti. E urdhëroi Xhibrili sërish ta mbulojë.

Më pas pamë një njeri i ulur dhe i priste shpirtat e të vdekurve. Disave ju thoshte: Shpirt i mirë, ke dalë nga njeriu i mirë, dhe iu gëzoheshte pamasë. Disave anasjelltas, of për shpirtin e keq që ke dalë nga njeriu i keq, dhe iu hidhëroheshte pamasë.

E pyeta Xhibrilin se kush ishte ky njeri. Ai më tha: Babai yt Ademi a.s. i cili iu gëzohet bijve të tij të mirë dhe iu hidhërohet të kqijve.

Më pas pamë njerëz që në duart e tyre kishin shkëmbi të zjartë, e gjuanin në gojë të tyre dhe sërish e nxjerrnin. I thash o Xhibril, çka është me këta njerëz? Më tha: Këta janë njerëzit që kanë hëngër pasurinë e jetimit pa leje.

Pash edhe disa njerëz me barqe shumë të mëdhej saqë kurë nuk kam parë më parë, që vraponin të gjenin uj sikur devet shumë të etura. I thash kush janë këta njerëz o Xhibril? Këta janë ata që e kanë hëngër kamatën.

Pastaj pash njerëz që para tyre kishin mish. Njëri mish i mirë shumë dhe i majmë, kurse tjetri krejt koc dhe i keq. Ata e hanin (mishin) kocin dhe e lenin të majmin. Kush janë këta o Xhibril?

Këta janë Zinaçarët¹¹ që e kanë lënë Hallallin dhe kanë shkuar pas Haramit¹²

Poashtu aty pamë edhe Zinaçare (gra) në pozitë shumë të keqe dhe Xhibrili më tregoi se ato ishin prostetutet.

Ngjitja në qiellin e dytë. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaiqe pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët. Aty ishte Isau i biri i Merjemes dhe Jahja i biri i Zekerijës. Më thanë: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Ngjitja në qielli e tretë. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaiqe pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha:

¹¹ Bura t e martuar që kanë pasur kontakte me gra jo të tyre

¹² që e ka lejuar Allahu, dhe që e ka ndaluar

Mirëserdhët. Aty pashë një njeri të bukur sikur hëna natë e Bedrit. Thashë: Kush është ky o Xhibril? Më tha vëllau yt Jusufi djali i Jakubit a.s. jusufi më tha: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Ngjitja në qiellin e katërt. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaïke pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët. Aty ishte një njeri në pozitë të lartë dhe të respektuar. E pyeta Xhibrilin kush ishte ky njeri. Më tha Idrizi a.s. dhe mu kujtuan fjalët e Allahut xh.sh. **“dhe e kemi ngritur në pozitë të lartë (Idrizin)”**¹³ Idrizi a.s. tha: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Ngjitja në qiellin e pestë. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaïke pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët. Aty ishte një njeri i moshës mesatare dhe shumë i bukur. Xhibrili më tregoi se ky ishte Haruni vëllau i Musës a.s. Ai më tha: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Ngjitja në qiellin e gjashtë. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaïke pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët. Aty ishte një njeri i gjatë dhe i hollë, i cili mund të thuash se ju ngjante burave të Shen`udit. Xhibrili a.s. më tha ky është Musa a.s. Ai më tha: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Ngjitja në qiellin e shtatë. Trokiti Xhibrili a.s. dhe kërkoi leje të kalojmë.

Kjo Melaïke pyeti kush është me ty o Xhibril? Ai i tha : Muhamedi. Pyeti: A i ka ardhur shpallja? Tha: Po. Ai tha: Mirëserdhët. Aty pashë një njeri që kush në botë nuk i përngjante më shumë se ai shokut tuaj, i cili rinta pranë Bejtul Ma`mures¹⁴, në të cilën çdo ditë hynë nga 70.000 melaïke dhe nuk kthehen në të sërish deri në ditën e

¹³ Merjem 57

¹⁴ Bejtul Ma`mure është vendi në të cilë i bëhet adhurim Allahut pa ndërpre nag engjujt. Së pari do të ngrihet vlera e Kur`anit nga kjo botë dhe do të shtyhet në të e më pas do të kris Kijameti.

Israja dhe miraxhi.doc-Bekim Alimi

Kijametit. Kush është ky o Xhibril? Më tha Babai yt¹⁵ Ibrahim. Ai tha: Mirëse erdhe pejgamber dhe vëlla i dashur.

Pastaj mu tregua xhenneti dhe të mirat e tij. Në të pashë një Hurije¹⁶ që kurrë më parë nuk kisha pa ashtu vajze të bukur. E pyeta për kë të ka falë Allahu xh.sh.? më tha jam duke e pritur Zejd ibn Harithin. Dhe me të kthyer unë në tokë thash do ti tregoj Zejdit.

Ky ishte edhe vendi i fundit ku e shoqëroi Xhibrili. Më pas u takua¹⁷ me Allahun xh.sh. ku edhe nuk e çonte kryet prej sexhdes.

Allahu e urdhëroi të e çon kryet dhe e përgëzoi se çdo dua¹⁸ e tij do t'i pranohet. Pejgamberi a.s. tha: O Allah Ummeti im, Ummeti im, Ummeti im.

Allahu xh.sh. i tha se Unë do të obligoj ty dhe ummetin tënd me 50 kohë namazi. Kush i krye ato ia garantoj xhenetin.

Pejgamberi a.s. me dëshirë të madhe i pranoi duke e ditur se ummeti i tij bën punë dhe lodhje shumë më të mëdha, dhe se ishte i sigurtë se edhe namazin do ta kryejnë.

E mori porosinë Muhamedi a.s. dhe kthehet në tokë. Në qiellin e gjashtë takon Musën a.s. i cili ie pyeti se 4ka të porositi Allahu për umetin? Ai Tha me 50 kohra namzi.

Musa a.s. i tha unë kam qenë te Beni Israilët dhe të tregoj se janë shumë 50 kohra, po ti kthehu sërish te Allahu dhe kërkë lehtësim për ummetin.

U kthye Muhamedi a.s. dhe Allahu ia lehtësoi 45, sërish Musa a.s. e ktheu, Allahu ia lehtësoi në 40, 35, 30, 25, 20, 15, 10, dhe në fund në pesë.

Musa a.s. i tha se pësëri janë shumë dhe ummeti nuk do të mund t'i kryejë. Muhamedi a.s. tha unë më nuk mund të kërkë ende lehtësim pas krejt këtij lehtësimi.

¹⁵ Babai i Muhamedit është Abdullah ibn Abdulmutalib, por këtu është thënë se Ibrahim a.s. ishte babai i Ismailit a.s. prej të cilit rrjedh kombi arab.

¹⁶ Hurije janë bukuroshe të xhenetit që i ka krijuar Allahu për xhenetlijt. Në një hadith ku e shpjegon Muhamedi a.s. bukurinë e tyre thot: “Po të dalë një kime e flokës së Hurijes në këtë botë, do t'ia merte shkëlqimin diellit.”

¹⁷ Sipas dijetarëve islam, asnjë njeri nuk e ka parë Allahun, e as Muhamedi a.s. por Muhamedi a.s. ka parë Nurin (Dritën) e Allahut dhe ka biseduar me Të më afër sesa ndonjë njeri në botë.

¹⁸ lutje

Atëherë u dëgjua një zë nga Allahu xh.sh. O Muhamed kush i fal pesë kohrat Unë do tia shkruaj 50.

Pasi merr dhuratën Pejgamberi a.s. kthehet në tokë dhe lajmëron se çka i ka ndodhë.

Ai iu tregoi se kish parë xhehenemin, xhennetin, drurin e Mallkuar¹⁹ që përmendet në Kur`an etj. Të paktët ishin ata që e besuan këtë Mrekulli të madhe të Pejgamberit.

Së shpejti shkuan mushrikët²⁰ te Ebu Bekri dhe i thanë: “A ke dëgjuar tash shokun tënd çka thot? Thot se për një pjese të shkurtër të natës ka shkuar deri në Mesxhidi Aksa, e pastaj në qeillra të larta.”

Ebu Bekri tha: A e ka thënë ai këtë fjalë apo ju i nxirni prej mendeve tuaja? Thanë jo ai vet, e po të duash eja e pyesim. Ebu Bekri tha: Nëse e ka thënë ai, e ka qëlluar. Ai nuk gënjen kurrë. Unë i besoj se i vijnë lajmet nga Zotit për një kohë të shkurtër, e pse mos me e besuar edhe këte.

Shkoi Ebu Bekri dhe disa mushrik te Muhamedi a.s. dhe i thanë: Ne e dimë se ti kurrë nuk ke qenë në Bejtul Makdis (Kuds), përshkruana si duket ai.

Muhamedi a.s. thot: Mua nuk mu kujtoheshte ahumë mirë sepse ishte natë kur unë shkova atje dhe e çova kryet lart në qiell Allahu xh.sh. ma paraqiti Kuds, e shihnja dhe shpjegoja.

Çdo fjalë që e thonte Pejgamberi a.s. Ebu Bekri që disa herë kishte qenë atje i thoshte: „**Saddekte, ve esh-hedu enneke resulullah**“ E qëlllove dhe dëshmoj se je i dërguari i Allahut.

Derisa e mbaroi Pejgamberi a.s. dhe i tha: **“Bel entes siddiku ja Eba Bekr”** Ty je i drejti dhe i sinqerti o Ebu Bekr.

Disa prej besimtarëve kur dëgjua këta lajme nuk mundnint`iu besojnë dhe dolën nga besimi i drejtë. Në atë rast i zbriti Muhamedit a.s. Xhibrili me ajetin Kur`anor:

„E atë pamjen tënde që të treguam (natën e Miraxhit) dhe pemën e mallkuar (që përmendet në Kur`an), nuk i bëmë pos sprovë për njerëz. Ne i friksuam ata (idhujtarët) po nuk u shton ai tjetër vetëm se rebelim të madh.“²¹

Edhe ne të besojmë se ti je i dërguari i Allahut ja resulallah.

¹⁹ Druri i Mallkur emri i të cilit është ZEKUM

²⁰ Mushrik, person që ka besuar në shumë zotra

²¹ El Isra 60